PRIZREN	Hudhje & Pushim	9	173	27	1	573	3	20	447	4	1257	35.70%
	Aktakuza	51	1360	39	13	370		28	338	7	2206	62.65%
	Mënyrë tjetër	3	13			28			14		58	1.65%
PEJË	Hudhje & Pushim		113	3		360		28	132	6	642	36.71%
	Aktakuza	1	742	7		180		24	141	3	1098	62.78%
	Mënyrë tjetër		6					1	2		9	0.51%
GJILAN	Hudhje & Pushim	2	36	14		446		7	111	1	617	29.71%
	Aktakuza	16	725	62		287		33	336		1459	70.25%
	Mënyrë tjetër					1					1	0.04%
MITROVICË	Hudhje & Pushim		103	9		196		11	227	6	552	28.15%
	Aktakuza	6	863	12		260		72	186		1399	71.34%
	Mënyrë tjetër		1			8			1		10	0.51%
FERIZAJ	Hudhje & Pushim	5	57	6		216		8	173		465	21.89%
	Aktakuza	47	913	25	2	234		81	332	7	1641	77.26%
	Mënyrë tjetër		4	1		4			9		18	0.85%
GJAKOVË	Hudhje & Pushim	3	50	8		176		12	64		313	28.25%
	Aktakuza	5	445	16		182		24	111	3	786	70.94%
	Mënyrë tjetër	1	3	1		2		1	1		9	0.81%

Figura 48

Nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura në raport me mënyrat tjera të procedimit, përgjatë viteve 2013-2020, rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Ferizaj me **77.26%**, ndërsa PSRK-ja me **47.54%** rezulton të ketë nivelin më të ulët (*shih figurën 49*).




Figura 49

² Mënyrë tjetër nënkupton procedimin e rasteve për persona me bashkim të procedurës, transferim të procedurës në shtetit tjetër dhe masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik.

4.3 NGARKESA ME LËNDË (KALLËZIME PENALE ME PERSONA): 31.12.2020

Në fund të vitit 2020 (31 dhjetor 2020), ngarkesa me lëndët e veprave penale karakteristike përbëhej nga 2023 kallëzime penale dhe 3732 persona, prej të cilave nivelin më të lartë të pjesëmarrjes rezultojnë të kenë veprat penale të Drogave me 50.82% të kallëzimeve penale dhe 39.60% të personave, ndërsa nivelin më të ulët Nxitja urrejtjes me 0.69% të kallëzimeve penale dhe 1.77% të personave (shih figurën 50).

	A		DR		KM		KO		KORR		SHP		TNJ		E		NU		Totali: 2020	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
PSRK	2	2	6	14	7	11	35	205	44	195	34	84	1	3	3	32	9	59	141	605
PRISHTINË	12	15	634	910	24	60			106	331			49	101	169	262	3	3	997	1682
PRIZREN	2	2	24	49	3	8			29	89			8	12	23	47			89	207
PEJË			49	68	2	3			21	38			1	2	29	48	1	1	103	160
GJILAN			6	7	2	2			8	8					15	53			31	70
MITROVICË	5	16	212	299	9	21			83	151			26	39	146	206	1	3	482	735
FERIZAJ	2	2	18	26	2	2			14	41			5	6	16	25			57	102
GJAKOVË	2	5	79	105	5	7			12	28			2	2	23	35			123	182
#	25	42	1028	1478	54	114	35	205	317	881	34	84	92	165	424	708	14	66	2023	3732

Figura 50

PTh.Prishtinë me 997 (apo 49.28%) të kallëzimeve penale dhe 1682 (apo 45.07%) të personave, rezultojnë të ketë nivelin më të lartë të ngarkesës me lëndë, ndërsa PTh.Gjilan me 31 apo (1.53%) të kallëzimeve penale dhe 70 apo (1.88%) të personave rezultojnë të ketë nivelin më të ulët të ngarkesës me lëndë (shih figurën 51).




Figura 51

4.4 MBYLLJA E INFORMATAVE PPN ME PERSONA

Prokuroritë përgjatë tetë viteve 2013-2020 kanë pranuar 4530 Informata PPN të reja me 7092 persona, prej të cilave përgjatë tetë (8) viteve kanë mbyllur 4013 Informata PPN me 6320 persona. Nga këto të dhëna rezulton se prokuroritë, përgjatë 8 viteve, kanë mbyllur 88.59% të Informatave PPN të pranuar dhe 89.11% të personave të pranuar, që rezulton me kuotën e përbashkët (PPN dhe Persona) të përqindjes së mbylljes prej 88.85% (*shih figurën 50*).

	Pranuar 2013-2020	Proceduar 2013-2020	%	% përbashkët
Informata PPN	4530	4013	88.59%	88.85%
Persona	7092	6320	89.11%	

Figura 50

Prokuroria themelore në Prishtinë, rezulton të ketë nivelin më të lartë të mbylljes së rasteve (*Informata PPN me persona*), me kuotën **100.91%**, në raport rastet e pranuar (*Informata PPN me persona*), përgjatë tetë viteve 2013-2020, ndërsa Prokuroria themelore në Mitrovicë me kuotën prej **52.30%** rezulton të ketë nivelin më të ulët (*shih figurën 51*).

EFIKASITETI NE MBYLLJEN E INFORMATAVE ME PERSONA: 2013-2020					
		PRANUAR	MBYLLUR	%	% PPN + % persona=% totale
PRISHTINË	Informata PPN	1587	1583	99.75%	100.91%
	Persona	2518	2570	102.07%	
FERIZAJ	Informata PPN	484	451	93.18%	91.94%
	Persona	623	565	90.69%	
PSRK	Informata PPN	519	428	82.47%	84.98%
	Persona	1302	1139	87.48%	
PRIZREN	Informata PPN	380	329	85.58%	84.32%
	Persona	543	451	83.06%	
GJILAN	Informata PPN	115	100	86.96%	82.82%
	Persona	150	118	78.67%	
PEJË	Informata PPN	1179	948	80.41%	80.03%
	Persona	1547	1232	79.64%	
GJAKOVË	Informata PPN	148	108	72.97%	71.70%
	Persona	213	150	70.42%	
MITROVICË	Informata PPN	118	66	55.93%	52.20%
	Persona	196	95	48.47%	

Figura 51

5. PËRFUNDIME

5.1. KONSTATIME

1. KONSTATIME LIDHUR ME SUBJEKTET PARASHTRUESE TË KALLËZIMEVE PENALE:2013-2020

(1) Konstatohet se nga tërësia prej 14281 kallëzimeve penale të parashtruara nga subjektet e ndryshme nëpër prokurori përgjatë tetë viteve (2013-2020), rezulton se:

- 5.87% (apo 839) apo janë parashtruar nga QYTETARËT/I DËMTUARI;
- 1.21% (apo 173), janë inicuar nga PROKURORËT ME VET-INICIATIVË;
- 92.91% (apo 13269) janë parashtruar nga INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA (13 subjekte);

(2) Konstatohet se tri (3) vepra penale (grupe), përbëjnë rreth 90% të tërësisë së veprave penale të parashtruara përmes kallëzimeve penale përgjatë tetë viteve (2013-2020):

1. DROGAT me 48.28% të kallëzimeve penale (98% e rasteve nga Policia),
2. KORRUPSIONI me 23.49% të kallëzimeve penale (41% nga Policia, 20% nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, 22% nga qytetarët, etj.)
3. KRIMET EKONOMIKE me 22.13% të kallëzimeve penale (74% nga policia, 13% nga Dogana, 7% nga ATK, Qytetarët 1.61%, etj);

(3) Konstatohet se Policia e Kosovës është subjekti me nivelin më të lartë të parashtrimit të kallëzimeve penale për veprat penale karakteristike përgjatë 8 viteve:

- 78%, POLICIA E KOSOVËS (*niveli më i lartë i parashtrimit të kallëzimeve penale*),
- 6%, QYTETARI/I DËMTUARI,
- 5%, AGJENSIONI KUNDËR KORRUPSIONIT,
- 3%, DOGANA,
- 0.04% AUDITORI GJENERAL,
- 0.03%, NJËSIA INTELIGJENCËS FINANCIARE (*niveli më i ulët i parashtrimit të K.Penale*).

2. KONSTATIMI LIDHUR ME EFIKASITETIN NË PROCEDIMIN E RASTEVE: 2013-2020

2.1. Konstatime për nivelin e efikasitetit në trajtimin e kallëzimeve penale

- (4) Konstatohet se efikasiteti i sistemit prokurorial në trajtimin e kallëzimeve penale për veprat penale karakteristike (2013-2020), është në kuotën prej 90.10% (*janë pranuar 14281 ndërsa janë proceduar 12867 kallëzime penale*);
- (5) Konstatohet se vepra penale “Shpërlarja e parasë”, me kuotën prej 99% rezulton të ketë nivelin më të lartë të efikasitetit në procedimin e kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranaura 2013-2020 (*vërejtje: mostra është e ulët sepse janë pranuar 81 ndërsa janë proceduar 80 kallëzime penale*);

- (6) Konstatohet se veprat penale të "Korrupsionit" me kuotën prej 96%, përbëjnë grupin e dytë të veprave penale sipas kriterit të procedimit *(janë pranuar 3353 ndërsa janë proceduar 3231 kallëzime penale)*;
- (7) Konstatohet se veprat penale "Trafikimi me njerëz", me kuotën prej 79%, përbëjnë efikasitetin më të ulët të kallëzimeve penale të proceduara në raport me kallëzimet penale të pranuar të reja *(janë pranuar 308 ndërsa janë proceduar 242 kallëzime penale)*;
- (8) Konstatohet se prokuroria Themelore në Prizren me kuotën prej 101% të procedimit të kallëzimeve penale rezulton të ketë performancën më të lartë në raport me prokuroritë tjera *(janë pranuar 2331 ndërsa janë proceduar 2345 kallëzime penale)*;
- (9) Konstatohet se prokuroria Themelore në Mitrovicë me kuotën prej 81% të procedimit të kallëzimeve penale rezulton të ketë performancën më të ulët në raport me prokuroritë tjera *(janë pranuar 1578 ndërsa janë proceduar 1283 kallëzime penale)*;

2.2. KONSTATIME PËR NIVELIN E EFIKASITETIT NË TRAJTIMIN E RASTEVE PËR PERSONA: 2013-2020

(10) Konstatohet se efikasiteti në trajtimin e rasteve për persona të përfshirë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike (2013-2020), është në kuotën prej 93.47% *(janë pranuar 22956 ndërsa janë proceduar 21457 persona)*;

(11) Konstatohet se efikasiteti i kënaqshëm përbënë tejkalimi i kuotën mbi 100% të personave të proceduar në raport me numrin e personave të pranuar gjatë periudhës 2013-2020. Në këtë kontekst theksojmë se kuota e procedimit të personave është tejkaluar për tri grupe të veprave penale:

1. Shpërlarja e parasë me kuotën 129% *(pranuar 225 ndërsa proceduar 290 persona)*;
2. Krimi organizuar me kuotën 105% *(pranuar 728 ndërsa proceduar 768 persona)*;
3. Korrupsioni me kuotën 102% *(pranuar 6824 ndërsa proceduar 6988 persona)*;

(12) Konstatohet se veprat penale të Drogave me kuotën 87% të procedimit të personave në raport me personat e pranuar përgjatë viteve 2013-2020, rezultojnë të kenë nivelin më të ulët në raport me të gjitha grupet tjera të veprave penale karakteristike;

(13) Konstatohet se prokuroria speciale me kuotën prej 120% të procedimit të personave rezulton të ketë performancën më të lartë në raport me prokuroritë tjera *(janë pranuar 1859 ndërsa janë proceduar 2238 persona)*;

(14) Konstatohet se prokuroria Themelore në Prizren me kuotën prej 100.3% të procedimit të personave rezulton që së bashku me Prokurorinë speciale të jenë të vetmet prokurori që kanë tejkaluar kuotën prej 100% të procedimit të personave në raport me personat e pranuar *(janë pranuar 3512 ndërsa janë proceduar 3521 persona)*;

(15) Konstatohet se prokuroria Themelore në Mitrovicë me kuotën prej 82% të procedimit të personave rezulton të jetë prokuroria me nivelin më të ulët të performances në procedimin e personave në raport me numri personave të pranuar *(janë pranuar 2386 ndërsa janë proceduar 1961 persona)*;

(16) Konstatohet se nivelin më të lartë të procedimit të personave rezulton të ketë PTh.Prishtinë me 31% të tërësisë së personave të proceduar përgjatë tetë (2013-2020) viteve (Prishtina 6679 persona – sistemi 21457 persona), ndërsa prokuroritë tjera kanë këto përqindje të pjesëmarrjes në tërësinë e sistemit:

#	Prokuroria	%	Persona të proceduar 2013-2020	Sistemi: 2013-2020
1	Prishtinë	31.13%	6679	21457
2	Prizren	16.41%	3521	21457
3	PSRK	10.43%	2238	21457
4	Ferizaj	9.90%	2125	21457
5	Gjilan	9.68%	2077	21457
6	Mitrovicë	9.14%	1961	21457
7	Pejë	8.15%	1749	21457
8	Gjakovë	5.16%	1107	21457

(17) Konstatohet se në bazë të analiza krahasimore në mes dy (2) indikatorëve të matshëm: (1) numrit të përgjithshëm të personave të pranuar përgjatë viteve (2013-2020), dhe ngarkesës me lëndë të mbetura në fund të vitit 2020 (31 dhjetor 2020), dhe (2) Numrit të personave të proceduar (kryer/zgjidhur), përgjatë viteve tetë viteve (2013-2020), rezulton me nivelet e performancës sipas renditjes së prokurorive:

#	Prokuroria	%	Persona të pranuar	Ngarkesa 31.12.2020	Totali	Persona të proceduar	Numri prokurorëve
1	Ferizaj	94.46%	2101	102	2203	2125	16
2	Prizren	94.68%	3512	207	3719	3521	21
3	Gjilan	91.50%	2200	70	2270	2077	14
4	PSRK	90.83%	1859	605	2464	2238	15
5	Gjakovë	85.88%	1107	182	1289	1107	10
6	Pejë	84.57%	1908	160	2068	1749	18
7	Prishtinë	71.70%	7633	1682	9315	6679	51
8	Mitrovicë	62.83%	2386	735	3121	1961	19

(18) Konstatohet se sipas analizës krahasimore në mes të numrit të prokurorëve në prokurori³ dhe numrit të personave të proceduar rezulton me këtë nivel të performancës së prokurorive:

#	Prokuroria	Një prokuror ka proceduar për tetë vite (2013-2020)	(info) Ngarkesa për prokuror
1	Prizren	168 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	177 persona
2	PSRK	149 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	164 persona
3	Gjilan	148 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	162 persona
4	Ferizaj	133 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	138 persona
5	Prishtinë	131 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	182 persona
6	Gjakovë	111 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	129 persona
7	Mitrovicë	103 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	164 persona
8	Pejë	97 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike	115 persona

³ Gjendja numerike e prokurorëve më, 31 dhjetor 2020.

3. KONSTATIME LIDHUR ME NGARKESËN ME KALLËZIME PENALE DHE PERSONA: 2013-2020

3.1. Konstatime lidhur me ngarkesën me kallëzime penale

(19) Konstatohet se nga vitit 2013 deri në vitin 2016 në vazhdimësi është rritur ngarkesa me kallëzime penale për veprat penale karakteristike, në vitet 2017 dhe 2020 është zvogëluar ndërsa në dy vitet e fundit ngarkesa me lëndë është rritur:

- Në vitin 2013, ngarkesa me lëndë përbënte 893 kallëzime penale,
- Në 2014, ngarkesa me lëndë përbënte 1662 kallëzime penale, *(769 më shumë se 2013);*
- Në 2015, ngarkesa me lëndë përbënte 1915 kallëzime penale, *(253 më shumë se 2014);*
- Në 2016, ngarkesa me lëndë përbënte 1960 kallëzime penale, *(45 më shumë se 2015);*
- Në 2017, ngarkesa me lëndë përbënte 1927 kallëzime penale, *(33 më pak se viti 2016);*
- Në 2018, ngarkesa me lëndë përbënte 1753 kallëzime penale, *(174 më pak se viti 2017);*
- Në 2019, ngarkesa me lëndë përbënte 1820 kallëzime penale, *(67 më shumë se viti 2018);*
- Në 2020, ngarkesa me lëndë përbënte 2023 kallëzime penale, *(203 më shumë se 2019).*

(20) Konstatohet se ngarkesën me kallëzime penale (2023), në 2020 përbëjnë tri (3) vepra penale:

1. DROGAT⁴ me 50.82% apo 1028 kallëzime penale,
2. KRIMET EKONOMIKE me 20.96% apo 424 kallëzime penale,
3. KORRUPSIONI me 15.67% apo 317 kallëzime penale,

⁴ Mbi konstatimin se në fund të vitit 2020, Drogat përbëjnë mbi 50% të tërësisë së ngarkesës me kallëzime penale për veprat penale karakteristike, theksojmë se kjo situatë është parashikuar në raportin hulumtues të vitit 2017. Pasojë e numrit të lartë të kallëzimeve penale për veprat penale të Drogave është se në grupin e veprave penale të Drogave në kuadër të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional janë përfshirë të gjitha veprat penale të kapitullit XXIII (Veprat penale të narkotikëve). Në grupin e veprave penale të Armëve në kuadër të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional është përfshirë vetëm një (1) vepër penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse". Në bazë të kësaj analogjie krahasimore dhe në pajtim me parimet e klasifikimit (Prevallë, 2013) dhe kategorizimit të grupeve në Mekanizmin përcjellës ndërinstitucional konstatohet se grupi i veprave penale të Drogave/Narkotikëve duhet të rishikohet nga institucionet krijuese të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, me qëllim që në këtë grup të mbetet vetëm ato vepra penale sipas analogjisë së grupit të Armëve ndërsa të largohen nga grupi. Për më tej, si pasojë e përfshirjes së të gjitha veprave penale të narkotikëve në Mekanizmin përcjellës ndërinstitucional rezulton se Drogat/Narkotikët përbëjnë nivelin dominant në të hapësirën territoriale të Republikës.

(21) konstatohet se ngarkesa me kallëzime penale në fund të vitit 2020 përbëhet nga 2023 kallëzime penale, prej të cilave sipas pjesëmarrjes së prokurorëve në këtë tërësi dhe llojit të veprave penale që përbëjnë ngarkesën nëpër prokurori rezultojnë si në vijim:

1. PTh.Prishtinë me 49.28% apo 997 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 63.59% apo 634 kallëzime penale
 - Krimet ekonomike me 16.95% apo 169 kallëzime penale,
 - Korrupsionit me 10.63% apo 106 kallëzime penale,
2. PTh.Mitrovicë me 23.83% apo 482 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 43.98% apo 212 kallëzime penale
 - Krimet ekonomike me 30.29% apo 146 kallëzime penale,
 - Korrupsionit me 17.22% apo 83 kallëzime penale,
3. PSRK me 6.97% apo 141 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Korrupsioni me 31.21% apo 44 kallëzime penale,
 - Krimi organizuar me 28.82% apo 35 kallëzime penale,
 - Shpërlarja parasë me 24.11% apo 34 kallëzime penale,
4. PTh.Gjakovë me 6.08% apo 123 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 64.23% apo 79 kallëzime penale,
 - Krimet ekonomike me 18.70% apo 23 kallëzime penale,
5. PTh.Pejë me 5.09% apo 103 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 47.57% apo 49 kallëzime penale,
 - Krimet ekonomike me 28.16% apo 29 kallëzime penale,
6. PTh.Prizren me 4.40% apo 89 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Korrupsioni me 32.58% apo 29 kallëzime penale,
 - Drogat me 26.97% apo 24 kallëzime penale,
 - Krimet ekonomike me 25.84% apo 23 kallëzime penale,
7. PTh.Ferizaj me 2.82% apo 57 kallëzime penale, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 31.58% apo 18 kallëzime penale,
 - Krimet ekonomike me 28.07% apo 16 kallëzime penale,
 - Korrupsionit me 24.56% apo 14 kallëzime penale,
8. PTh.Gjilan me 1.53% apo 31 kallëzime penale, respektivisht me nivelin më të ulët:
 - Krimet ekonomike me 48.39% apo 15 kallëzime penale,
 - Korrupsioni me 25.81% apo 8 kallëzime penale,
 - Krimet ekonomike me 19.35% apo 6 kallëzime penale,

3.2. Konstatime lidhur me ngarkesën me persona

(22) Konstatohet se në vitet 2013 dhe 2014 ngarkesa me persona është rritur, 2015, 2016 dhe 2017 është zvogëluar ndërsa në vitet 2019 dhe 2020 përsëri është rritur ngarkesa me persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike:

- Në vitin 2013, ngarkesa përbënte 2469 persona,
- Në 2014 ngarkesa përbënte 3541 persona, (1072 më shumë se 2013);
- Në 2015 ngarkesa përbënte 4042 persona, (501 më shumë se 2014);
- Në 2016 ngarkesa përbënte 3893 persona, (149 më pak se 2015);
- Në 2017 ngarkesa përbënte 3381 persona, (512 më pak se viti 2016);
- Në 2018 ngarkesa përbënte 3081 persona, (300 më pak se viti 2017);
- Në 2019 ngarkesa përbënte 3395 persona, (314 më shumë se viti 2018);
- Në 2020 ngarkesa përbënte 3743 persona, (348 më shumë se 2019).

(23) Konstatohet se ngarkesa me 3743 persona në vitin 2020, është pasojë e numrit të lartë të personave në tri (3) grupe të veprave penale karakteristike:

1. DROGAT me 39.48% apo 1478 persona,
2. KORRUPSIONI me 23.54% apo 881 persona,
3. KRIMET EKONOMIKE me 18.92% apo 708 persona.

(24) Konstatohet se në fund të vitit 2020, ngarkesa përbëhet nga 3743 personave, prej të cilëve sipas pjesëmarrjes së prokurorive në këtë tërësi dhe llojit të veprave penale që përbëjnë ngarkesën me persona nëpër prokurori rezultojnë si në vijim:

1. PTh.Prishtinë me 44.94% apo 1682 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 54.10% apo 910 persona,
 - Korrupsionit me 19.68% apo 331 persona,
 - Krimet ekonomike me 15.58% apo 262 persona.
2. PTh.Mitrovicë me 19.64% apo 735 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 40.68% apo 299 persona,
 - Krimet ekonomike me 28.03% apo 206 persona,
 - Korrupsionit me 20.54% apo 151 persona.
3. PSRK me 16.16% apo 605 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Krimi organizuar me 33.88% apo 205 persona,
 - Korrupsioni me 32.23% apo 195 persona,
 - Shpërlarja parasë me 13.88% apo 84 persona,
 - Nxitja urrejtjes me 9.75% apo 59 persona.
4. PTh.Prizren me 5.53% apo 207 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Korrupsioni me 43% apo 89 persona,
 - Drogat me 23.67% apo 49 persona,
 - Krimet ekonomike me 22.71% apo 47 persona,
5. PTh.Gjakovë me 4.86% apo 182 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 57.69% apo 105 persona,
 - Krimet ekonomike me 19.23% apo 35 persona,
 - Korrupsioni me 15.38% apo 28 persona.
6. PTh.Pejë me 4.27% apo 160 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Drogat me 42.50% apo 68 persona,
 - Krimet ekonomike me 30% apo 48 persona,
 - Korrupsion me 23.75% apo 38 persona.
7. PTh.Ferizaj me 2.73% apo 102 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - Korrupsionit me 40.20% apo 41 persona,
 - Drogat me 25.49% apo 26 persona,
 - Krimet ekonomike me 24.51% apo 25 persona.
8. PTh.Gjilan me 1.87% apo 70 persona, respektivisht me nivelin më të ulët:
 - Krimet ekonomike me 75.71% apo 53 persona,
 - Korrupsioni me 11.43% apo 8 persona,
 - Krimet ekonomike me 10% apo 7 persona.

4. KONSTATIME LIDHUR ME PERFORMANCËN E PROKURORIVE NË PROCEDIMIN E PERSONAVE: 2013-2020

4.1. Konstatime lidhur me procedimin e personave, sipas kriterit të veprës penale:

(25) Konstatohet se nga tërësia e rasteve prej 21457 personave të proceduar përgjatë viteve 2013-2020, numrin më të lartë të personave të proceduar sipas veprës penale rezultojnë të kenë Drogat me 8147 persona apo 38% nga tërësia e personave të proceduar për tetë vite, ndërsa numrin më të ulët rezultojnë të ketë Nxitja urrejtjes me 77 persona apo 0.36% të tërësisë.

(26) Konstatohet se sipas kriterit të mënyrës së procedimit nivelin më të lartë rezultojnë të ketë aktakuzat me gjithsej 13483 persona apo 62.84% nga tërësia e personave të proceduar për tetë vite.

(27) Konstatohet se prokuroritë përgjatë viteve 2013-2020 kanë hudhur kallëzimet penale për 4279 persona (apo 19.94%), ndërsa kanë pushuar hetimet për 3514 persona (apo 16.38%), që rezultojnë me kuotën përbashkët prej 36.32% të personave nga tërësia e personave të proceduar.

(28) Konstatohet se nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura për persona rezultojnë të kenë Drogat me 7108 persona apo me kuotën prej 52.72%, ndërsa Nxitja urrejtjes me 49 persona apo 0.36, rezultojnë të ketë nivelin më të ulët të pjesëmarrjes në aktakuzat e ngritura për tetë vite.

(29) Konstatohet se sipas kriterit të llojit të aktakuzave të ngritura përgjatë viteve 2013-2020, rezultojnë se Aktakuzat për persona të ngritura pas zhvillimit të hetimeve me 7915 apo 58.70% kanë nivelin më të lartë, pasuar nga aktakuzat e drejtpërdrejta për 4531 persona apo 33.61% ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të kenë aktakuzat për dhënien e urdhrit ndëshkimor me 1037 persona apo 7.69%.

(30) Konstatohet se nga tërësia prej 4279 rasteve të hudhura për persona përgjatë viteve 2013-2020, Korrupsioni me 2231 persona apo 52.14% rezultojnë të kenë nivelin më të lartë, ndërsa Nxitja urrejtjes me 8 persona apo 0.19% rezultojnë me nivelin më të ulët.

(31) Konstatohet se nga tërësia prej 3514 rasteve të pushimit të hetimeve për persona përgjatë viteve 2013-2020, Korrupsioni me 1945 persona apo 55.35% rezultojnë të kenë nivelin më të lartë, ndërsa Nxitja urrejtjes me 20 persona apo 0.57%, rezultojnë me nivelin më të ulët.

4.2. Konstatime sipas kriterit të prokurorive:

(32) Konstatohet se numrin më të lartë të personave të proceduar sipas prokurorive përgjatë viteve 2013-2020, rezultojnë të ketë PTh.Prishtinë me gjithsej 6679 persona apo 31.13% të tërësisë, ndërsa PTh.Gjakovë me 1107 persona apo 5.16% rezultojnë të ketë nivelin më të ulët. Për më tej, sipas kriterit të prokurorisë, llojit të veprës penale dhe periudhës 2013-2020, rezultojnë se:

- PSRK, ka ngritur 1064 aktakuza ndaj personave të akuzuar në veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë: 1) Krimi organizuar me 37.69% apo 401 persona dhe 2) Korrupsioni me 31.86% apo 339 persona;

- PTh.Prishtinë, ka ngritur 3830 aktakuza ndaj personave të akuzuar në veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat me 52.51% apo 2011 persona;
- PTh.Prizren, ka ngritur 2206 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 61.65% apo 1360 persona;
- PTh.Pejë, ka ngritur 1098 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 67.58% apo 742 persona;
- PTh.Gjilan, ka ngritur 1459 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 49.69% apo 725 persona;
- PTh.Mitrovicë, ka ngritur 1399 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 61.69% apo 863 persona;
- PTh.Ferizaj, ka ngritur 1641 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 55.64% apo 913 persona;
- PTh.Gjakovë, ka ngritur 786 aktakuza ndaj personave të akuzuar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të kenë Drogat 56.62% apo 445 persona;

(33) Konstatohet se nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura për persona rezulton të ketë PTh.Prishtinë me 3830 (apo 28.41%) persona, ndërsa PTh. Pejë me 1098 (apo 8.14%), persona rezulton me nivelin më të ulët. Sipas llojit të aktakuzës së ngritur rezulton se:

- Nga tërësia prej 1037 aktakuzave për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PTh.Prishtinë me 52.56% (apo 545), rezulton të ketë nivelin më të lartë, ndërsa PSRK me 1.74% (apo 18), rezulton të ketë nivelin më të ulët;
- Nga tërësia prej 4531 aktakuzave të drejtpërdrejta, të ngritura përgjatë 2013-2020, PTh.Prishtinë me 26.64% (apo 1207), rezulton të ketë nivelin më të lartë, ndërsa PSRK me 0.04% (apo 2), rezulton të ketë nivelin më të ulët;
- Nga tërësia prej 7915 aktakuzave pas zhvillimit të hetimeve, të ngritura përgjatë 2013-2020, PTh.Prishtinë me 26.25% (apo 2078), rezulton të ketë nivelin më të lartë, ndërsa PTh.Gjakovë me 6.96% (apo 551), rezulton të ketë nivelin më të ulët.

(34) Konstatohet se gjatë periudhës 2013-2020, prokuroritë kanë hudhur kallëzimet penale për 4279 persona, prej të cilëve 92% apo 3969 kallëzime penale janë të parashtruara nga Institucionet e specializuara të Republikës së Kosovës. Për më tej, konstatohet se nivelin më të lartë të hudhjes së kallëzimeve penale për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2020, rezulton të ketë PTh.Prishtinë me 41.72% nga tërësia e hudhjeve ndërsa PTh.Gjakovë me 4.21% rezulton me nivelin më të ulët të hudhjes së kallëzimeve penale për persona. Për më tej, sipas kriterit të prokurorisë, llojit të veprës penale, dhe periudhës 2013-2020, rezulton se:

- PSRK-ja, ka hudhur kallëzimin penal për 238 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezulton të ketë Korrupsioni me 49.16% (apo 117 persona);
- PTh.Prishtinë ka hudhur kallëzimin penal për 1785 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 57.25% (apo 1022 persona);

- PTh.Prizren ka hudhur kallëzimin penal për 717 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë 1) Krimet ekonomike me 43.51% (apo 312 persona), dhe 2) Korrupsioni me 41.98% (apo 301 persona);
- PTh.Pejë ka hudhur kallëzimin penal për 309 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 55.99% (apo 173 persona);
- PTh.Gjilan ka hudhur kallëzimin penal për 350 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 72.86% (apo 255 persona);
- PTh.Mitrovicë ka hudhur kallëzimin penal për 431 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë: 1) Krimet ekonomike me 42.69% (apo 184 persona), dhe 2) Korrupsioni me 36.66% (apo 158 persona);
- PTh.Ferizaj ka hudhur kallëzimin penal për 269 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë: 1) Krimet ekonomike me 45.72% (apo 123 persona), dhe 2) Korrupsioni me 40.15% (apo 108 persona);
- PTh.Gjakovë ka hudhur kallëzimin penal për 180 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë: Korrupsioni me 53.89% (apo 97 persona);

(35) Kontatojmë se gjatë periudhës 2013-2020, prokuroritë kanë pushuar hetimet ndaj 3514 personave, prej të cilave 92% apo 3232 kallëzime penale janë të parashtruara nga Institucionet e specialiuara të Republikës së Kosovës. Për më tej, konstatojmë se nivelin më të lartë të pushimit të hetimeve për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2020, rezultojnë të ketë PTh.Prishtinë me 29.31% nga tërësia e pushimit të hetimeve ndërsa PTh.Gjakovë me 3.76% rezultojnë me nivelin më të ulët të pushimit të hetimeve për persona. Për më tej, sipas kriterit të prokurorisë, llojit të veprës penale, dhe periudhës 2013-2020, rezultojnë se:

- PSRK-ja, ka pushuar hetimet për 894 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë 1) Korrupsioni me 36.02% (apo 322 persona) dhe 2) Krimi organizuar me 35.01% (apo 313 persona);
- PTh.Prishtinë, ka pushuar hetimet për 1030 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 72.62% (apo 748 persona);
- PTh.Prizren, ka pushuar hetimet për 540 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 50.37% (apo 272 persona);
- PTh.Pejë, ka pushuar hetimet për 333 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 56.16% (apo 187 persona);
- PTh.Gjilan, ka pushuar hetimet për 267 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 71.54% (apo 191 persona);
- PTh.Mitrovicë, ka pushuar hetimet për 121 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të kenë: 1) Krimet ekonomike me 35.54% (43 persona) dhe 2) Korrupsioni me 31.40% (apo 38 persona);
- PTh.Ferizaj, ka pushuar hetimet për 196 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 55.10% (apo 108 persona);
- PTh.Gjakovë, ka pushuar hetimet për 133 persona, prej të cilëve nivelin më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 59.40% (apo 79 persona);

5. KONSTATIME LIDHUR ME SUBJEKTET PARASHTRUESE TË INFORMATAVE PPN: 2013-2020

(36) Konstatohet se nga tërësia prej 3508 Informatave PPN të parashtruara nga subjektet e ndyshme nëpër prokurori përgjatë tetë viteve (2013-2020), rezultojnë se:

- 14.25% (apo 500) janë parashtruar nga QYTETARËT/I DËMTUARI;
- 0.37% (apo 13) janë inicuar nga PROKURORËT ME VETINICIATIVË;
- 85.38% (apo 2995), janë parashtruar nga INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA (13 subjekte).

Në këtë kontekst informatat PPN i referohen raporteve të veçanta të policisë përmes të cilave policia e njofton prokurorin e shtetit për mos egzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepër penale⁵. Përveç raporteve të veçanta (2202 Informatave PPN me 3082 persona) të parashtruara nga Policia e Kosovës, përgjatë viteve 2013-2020 janë regjistruar edhe informata PPN të parashtruara nga subjektet tjera (shih figurën 37), si në vijim:

- Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK): 42 Informatave PPN me 64 persona,
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK): 42 Informatave PPN me 50 persona,
- Dogana e Kosovës (DG): 124 Informatave PPN me 139 persona,
- Subjekti "E pranuar në kompetencë"⁶ (EPK): 163 Informatave PPN me 328 persona,
- Inspektorati Policor i Kosovës (IPK): 272 Informatave PPN me 540 persona,
- Njësia Inteligjencës Financiare (NJIF): 18 Informatave PPN me 38 persona,
- Organi Administratës Komunale (OAK): 41 Informatave PPN me 49 persona,
- Titullari Pronës (TP): 58 Informatave PPN me 71 persona,
- Auditori Gjeneral (AGJ): 33 Informatave PPN me 54 persona,
- Prokurori me vet-iniciativë (PV): 13 informatave PPN me 18 persona,
- I dëmtuari (ID): 273 Informatave PPN me 546 persona,
- Qytetarët (Q): 227 Informatave PPN me 507 persona.

(37) Konstatohet se dy (2) grupe të veprave penale karakteristike, përbëjnë rreth 86% të tërësisë së Informatave PPN të parashtruara përgjatë tetë viteve (2013-2020):

1. KORRUPSIONI me 50.34% (apo 1766) të Informatave PPN (prej të cilave: Policia me 41%, Qytetari me 26% dhe Inspektorati Policor i Kosovës 15%);
2. KRIMET EKONOMIKE me 36% (apo 1248) të Informatave PPN (Policia 84%);

(38) Konstatohet se subjektet me nivelin më të lartë dhe më të ulët të parashtrimit të kallëzimeve penale gjatë 8 viteve:

- 63% (apo 2202), POLICIA E KOSOVËS (niveli më i lartë i parashtrimit të rasteve),
- 14% (apo 500), QYTETARI/I DËMTUARI,
- 8%, (apo 272), INSPEKTORIATI POLICOR I KOSOVË,
- 3%, (apo 124), DOGANA,
- 0.37% (apo 13), PROKURORI ME VET INICIATIVË

6. KONSTATIMI LIDHUR ME EFIKASITETIN NË MBYLLJEN E INFORMATAVE PPN ME PERSONA: 2013-2020

6.1. Konstatime për nivelin e efikasitetit në mbylljet e Informatave PPN

⁵ Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, (2012), neni 81, par.4 "Nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepër penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit".

⁶ Raste të cilat një herë janë regjistruar në ndonjërin prej prokurorive.

- (39) Konstatohet se efikasiteti i sistemit prokurorial në trajtimin e Informatave PPN për veprat penale karakteristike (2013-2020), rezultojnë të jetë në kuotën prej 88.59% *(janë pranuar 4530 ndërsa janë mbyllur 4013 Informata PPN)*;
- (40) Konstatohet se Kontrabandimi me migrant me kuotën prej 119% rezultojnë të ketë nivelin më të lartë të efikasitetit në mbylljen e Informatave PPN në raport me Informatave PPN të pranuar përgjatë periudhës kohore: 2013-2020, *(vërejtje: mostra është e vogël, sepse janë pranuar 21, ndërsa janë mbyllur 25)*;
- (41) Konstatohet se Korrupsioni, me kuotën prej 92%, rezultojnë të ketë nivelin më të lartë *(prej grupeve me sasi të lartë të Informatave PPN)*, të mbylljes së Informatave PPN në raport me Informatat PPN të pranuar gjatë periudhës kohore: 2013-2020, *(janë pranuar 2744 ndërsa janë mbyllur 2534)*;
- (42) Konstatohet se Krimi organizuar me kuotën prej 73%, përbëjnë efikasitetin më të ulët të mbylljes së Informatave PPN në raport me Informatat PPN të pranuar përgjatë periudhës kohore: 2013-2020 *(janë pranuar 48 ndërsa janë mbyllur 35 Informata PPN)*;
- (43) Konstatohet se Prokuroria Themelore në Prishtinë me kuotën prej 99% të mbylljes së Informatave PPN për veprat penale karakteristike, rezultojnë të ketë performancën më të lartë në raport me prokuroritë tjera *(janë pranuar 1587 ndërsa janë mbyllur 1583 Informata PPN)*;
- (44) Konstatohet se Prokuroria Themelore në Mitrovicë me kuotën prej 56% të mbylljes së Informatave PPN për veprat penale karakteristike, rezultojnë të ketë performancën më të ulët në raport me prokuroritë tjera *(janë pranuar 118 ndërsa janë mbyllur 66 Informata PPN)*;


6.2. Konstatime mbi efikasitetin në mbylljen e rasteve për persona në Informatat PPN

- (45) Konstatohet se efikasiteti i sistemit prokurorial në trajtimin e personave *(në Informatat PPN)* për veprat penale karakteristike (2013-2020), rezultojnë të jetë në kuotën prej 89.11% *(janë pranuar 7092 ndërsa janë mbyllur rastet për 6320 persona)*;
- (46) Konstatohet se Armët dhe Kontrabandimi me migrant, tejkalojnë kuotën prej 100% të mbylljes së rasteve për persona, mirëpo meqenëse mostra është e ulët nuk trajtohet në këtë konstatim;
- (47) Konstatohet se Korrupsioni, me kuotën prej 91%, rezultojnë të ketë nivelin më të lartë *(prej grupeve me numër të lartë të personave)*, të mbylljes së rasteve për persona në raport me numrin e personave të pranuar gjatë periudhës kohore: 2013-2020, *(janë pranuar 4789 ndërsa janë mbyllur 4403)*;
- (48) Konstatohet se Krimi organizuar me kuotën prej 64%, përbëjnë efikasitetin më të ulët të mbylljes së rasteve për persona në raport me rastet e pranuar për persona përgjatë periudhës kohore: 2013-2020 *(janë pranuar 178 ndërsa janë mbyllur 114 raste për persona)*;
- (49) Konstatohet se Prokuroria Themelore në Prishtinë është e vetmja që ka tejkeluar kuotën prej 100%, *(saktë 102%)*, të mbylljes së rasteve për persona, në Informatat PPN, për veprat penale karakteristike, *(janë pranuar 2518 persona ndërsa janë mbyllur rastet për 2570 persona)*;
- (50) Konstatohet se Prokuroria Themelore në Mitrovicë me kuotën prej 48% të mbylljes së rasteve për persona, në Informatat PPN, për veprat penale karakteristike, rezultojnë të ketë nivelin më të ulët *(janë pranuar 196 ndërsa janë mbyllur 95 Informata PPN)*.

(51) Konstatohet rritje të trendit në regjistrimin e rasteve të Korrupsionit në regjistrin PPN në raport me regjistrin PP.

- Nga tërësia prej 418 rasteve të Korrupsionit të pranuar në PSRK gjatë periudhës 2013-2020, në regjistrin PPN janë regjistruar 269 raste apo 64.35%, ndërsa në regjistrin PP ka regjistruar 149 raste apo 35.65%.
- Nga tërësia prej 798 rasteve të Korrupsionit të pranuar në PTh.Pejë gjatë periudhës 2013-2020, në regjistrin PPN janë regjistruar 464 raste apo 58.15%, ndërsa në regjistrin PP ka regjistruar 334 raste apo 41.85%.
- Nga tërësia prej 2744 raporteve të veçanta (PPN) për Korrupsion të regjistruara në të gjitha prokuroritë gjatë periudhës 2013-2020, rezulton se 1280 apo 46.65% i përketin PTh.Prishtinë. PTh.Prishtinë për vitet 2013-2015 (Para hyrjes në fuqi të planit strategjik⁷), ka pranuar gjithsej 659 raste të Korrupsionit, prej të cilave 518 apo 78.60% janë regjistruar në PP (Kallëzime penale) ndërsa 141 apo 21.40% në PPN (Raporte të veçanta). Ndërsa, gjatë periudhës 2016-2020 (Pas hyrjes në fuqi të planit strategjik) PTh.Prishtinë ka pranuar gjithsej 1939 raste të Korrupsionit, prej të cilave 796 apo 41.05% janë regjistruar në PP (Kallëzime penale), ndërsa 1143 apo 58.95% në PPN (Raporte të veçanta). Në tabelën në vijim pasqyrohet aspekti sasior i regjistrimit në rasteve të Korrupsionit në regjistrat PP dhe PPN për veprat penale të Korrupsionit, ndërsa në grafikun pasqyrohet ndryshimi, që ka ndodhur në vitin 2016, sasior në regjistrimin e rasteve në regjistrin PPN në raport me regjistrin PP.

Prishtinë	2013 viti		2014 v		2015 v		2016 v		2017 v		2018 v		2019 v		2020 v	
RASTE	183		265		211		408		442		402		386		297	
"PP"	126	68.85%	237	89.43%	155	73.46%	159	38.97%	208	47.06%	148	36.82%	164	42.49%	117	39.39%
"PPN"	57	31.15%	28	10.57%	56	26.54%	249	61.03%	238	53.85%	254	63.18%	222	57.51%	180	60.61%
	PARA PLANIT STRATEGJIK						GJATË PLANIT STRATEGJIK									



Si përfundim theksojmë se nga tërësia prej 1284 rasteve të Korrupsionit të regjistruara në regjistrin PPN të prokurorive përgjatë viteve 2013-2020 rezulton se:

- **18.54%** apo 238 raste (nga tërësia prej 1284 rasteve) janë të parashtruara nga Policia e Kosovës në reflektim të nenit 81, paragrafi 4 të Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale, që adreson njoftimin e policisë për moskallëzim penal,
- **84.27%** apo 1082 raste (nga tërësia prej 1284 rasteve) janë të parashtruara nga Organet publike (përfshirë Policinë), në reflektim të nenit 78 të Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale.
- **15.73%** apo 202 raste (nga tërësia prej 1284 rasteve) janë parashtruar nga personat në reflektim të nenit 79 të Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale.

⁷ Plani strategjik 2016-2019 për rritjen e efikasitetit të sistemin prokurorial në luftimin e korrupsionit.

⁸ Neni 81, paragrafi 4, të Kodit Nr.04/L-123 të Procedurës Penale: "Nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit".

7. KONSTATIME MBI NGARKESËN ME INFORMATA PPN DHE PERSONA: 2013-2020

7.1. Konstatime lidhur me ngarkesën me Informata PPN

- (52) Konstatohet se nga vitit 2013 deri në vitin 2016 në vazhdimësi është rritur ngarkesa me Informata PPN, nga viti 2017 deri në vitin 2019 ngarkesa me Informata PPN është zvogëluar, ndërsa në vitin 2020 ngarkesa me Informata PPN është rritur për 8 raste në raport me vitin 2019:
1. Në vitin 2013, ngarkesa me lëndë përbënte 304 Informata PPN,
 2. Në vitin 2014, ngarkesa me lëndë përbënte 423 Informata PPN (119 më shumë se 2013);
 3. Në vitin 2015, ngarkesa me lëndë përbënte 584 Informata PPN (161 më shumë se 2014);
 4. Në vitin 2016, ngarkesa me lëndë përbënte 1014 Informata PPN (530 më shumë se 2015);
 5. Në vitin 2017, ngarkesa me lëndë përbënte 948 Informata PPN (66 më pak se viti 2016);
 6. Në vitin 2018, ngarkesa me lëndë përbënte 927 Informata PPN (21 më pak se viti 2017);
 7. Në vitin 2019, ngarkesa me lëndë përbënte 882 Informata PPN (45 më pak se viti 2018);
 8. Në vitin 2020, ngarkesa me lëndë përbënte 890 Informata PPN (8 më shumë se 2019);
- (53) Konstatohet se ngarkesa me 890 Informata PPN në fund të vitit 2020, është krijuar si pasojë e nivelit të lartë të ngarkesës me lëndë të dy (2) grupe të veprave penale:
1. KORRUPSIONI me 62.13% apo 553 Informata PPN,
 2. KRIME EKONOMIKE me 27.75% apo 247 Info. PPN.
- (54) Ngarkesa me Informata PPN në fund të 2020, përbëhet nga 890 Informata PPN, ndërsa pjesëmarrja e prokurorëve në këtë tërësi të ngarkesës me lëndë rezulton të jetë si në vijim:
1. PTh.Prishtinë me 48.54% apo 432 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsionit me 69.21% apo 299 raste nga tërësia prej 432 Informatave PPN,*
 - *Krimeve ekonomike me 34.72% apo 130 raste nga tërësia prej 432 Informatave,*
 2. PTh.Pejë me 17.08% apo 152 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Krimeve ekonomike me 55.92% apo 85 raste nga tërësia prej 152 Informatave,*
 - *Korrupsionit me 30.92% apo 47 raste nga tërësia prej 152 Informatave PPN,*
 3. PSRK me 12.58% apo 112 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 51.79% apo 58 raste nga tërësia prej 112 Informatave PPN,*
 - *Shpërlarja parasë me 35.71% apo 40 raste nga tërësia prej 112 Informatave,*
 4. PTh.Mitrovicë me 8.20% apo 73 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 82.19% apo 60 raste nga tërësia prej 73 Informatave PPN,*
 5. PTh.Gjakovë me 4.83% apo 43 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 97.67% apo 42 raste nga tërësia prej 43 Informatave PPN,*
 6. PTh.Prizren me 4.38% apo 39 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 76.92% apo 30 raste nga tërësia prej 39 Informatave PPN,*
 7. PTh.Ferizaj me 4.16% apo 37 Informata PPN, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Krimeve ekonomike me 54.05% apo 20 raste nga tërësia prej 37 Informatave,*
 - *Korrupsionit me 40.54% apo 15 raste nga tërësia prej 37 Informatave PPN,*
 8. PTh.Gjilan me 0.22% apo 2 Informata PPN, respektivisht me nivelin më të ulët:
 - *2 Informata PPN për Korrupsion apo 100%.*

7.2. Konstatime lidhur me ngarkesën me persona (në Informatat PPN):

- (55) Konstatohet se ngarkesa me persona në Informatat PPN, ka qenë e ndryshueshme, respektivisht është rritur në vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2019, ndërsa është zvogëluar në vitet 2017, 2018 dhe 2020:
1. Në vitin 2013, ngarkesa përbënte 713 persona (*viti i krijimit të mekanizmit përcjellës*),
 2. Në vitin 2014, ngarkesa përbënte 933 persona (*220 persona më shumë se 2013*);
 3. Në vitin 2015, ngarkesa përbënte 1185 persona (*252 persona më shumë se 2014*);
 4. Në vitin 2016, ngarkesa përbënte 1697 persona (*512 persona më shumë se 2015*);
 5. Në vitin 2017, ngarkesa përbënte 1628 persona (*69 persona më pak se viti 2016*);
 6. Në vitin 2018, ngarkesa përbënte 1501 persona (*127 persona më pak se viti 2017*);
 7. Në vitin 2019, ngarkesa përbënte 1532 persona (*31 persona më shumë se viti 2018*);
 8. Në vitin 2020, ngarkesa përbënte 1424 persona (*108 persona më pak se viti 2019*);
- (56) Konstatohet se ngarkesa me 1424 persona në vitin 2020, është krijuar si pasojë e nivelit të lartë të ngarkesës me lëndë të dy (2) grupeve të veprave penale:
1. KORRUPSION me 65.45% apo 932 persona (*nga tërësia prej 1424 personave*)
 2. KRIMET EKONOMIKE me 21.42% apo 305 persona (*nga tërësia prej 1424 personave*)
- (57) Konstatohet se pjesëmarrja e prokurorëve në ngarkesën e përgjithshme prej 1424 personave në fund të vitit 2020, rezultojnë të jetë si në vijim:
1. PTh.Prishtinë me 43.12% apo 614 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsionit me 43.12% apo 451 persona nga tërësia prej 614 personave,*
 - *Krimeve ekonomike me 34.72% apo 160 persona,*
 2. PSRK me 18.19% apo 259 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 46.72% apo 121 persona,*
 - *Shpërlarja parasë me 30.89% apo 80 persona,*
 - *Krimi organizuar me 20.08% apo 52 persona,*
 3. PTh.Pejë me 14.04% apo 200 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Krimeve ekonomike me 49.50% apo 99 persona,*
 - *Korrupsionit me 39.50% apo 79 persona,*
 4. PTh.Mitrovicë me 10.60% apo 151 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 84.11% apo 127 persona,*
 5. PTh.Prizren me 4.78% apo 68 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 86.76% apo 59 persona,*
 6. PTh.Ferizaj me 4.78% apo 68 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Krimeve ekonomike me 47.06% apo 32 persona,*
 - *Korrupsionit me 47.06% apo 32 persona,*
 7. PTh.Gjakovë me 4.21% apo 60 persona, të cilën ngarkesë e përbëjnë:
 - *Korrupsioni me 98.33% apo 59 persona,*
 8. PTh.Gjilan me 0.28% apo 4 persona, respektivisht me nivelin më të ulët:
 - *4 persona për Korrupsion apo 100%.*

5.2 REKOMANDIME

1. Rekomandojmë shqyrtimin e klasifikimit dhe kategorizimit të veprave penale të grupit të Drogave në Mekanizmin Përcjellës Ndër-Institucional “MPN”, në atë mënyrë që Këshillit të merr vendim se cilat prej veprave penale të Narkotikëve të largohen nga grupi i Drogave në “MPN”, duke përdorur analogjinë e kategorizimit dhe klasifikimit të grupit të Armëve në “MPN”, sipas nocionit “*Trafikimi*” mbi të cilin janë kategorizuar grupet e MPN në vitin 2013.

Në grupin e Drogave në “MPN” janë të përfshira tetë (8) nga dhjetë (10) veprat penale të Narkotikëve të Kapitullit XXIII të Kodit Penal Nr.06/L-074 (*shih figurën a*). Përfshirja e këtyre tetë (8) veprave penale të Narkotikëve në grupin e Drogave në “MPN” është duke ndikuar në pjesëmarrjen me 50% në tërësinë e veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndër-Institucional. Për më tej, në vitin 2013 panorama e përgjithshme e personave të përfshirë në veprat penale të Korrupsionit (*ngjyra e verdhë*) përbënte veprën penale numër një në të gjitha prokuroritë ndërsa në vitet 2018, 2019 dhe 2020 veprat penale të Drogave (*ngjyrë vjollcë*) përbëjnë ngarkesën më të lartë në të gjitha prokuroritë themelore (*shih figurën b*).

Në grupin e Armëve në “MPN” është përfshirë vetëm një (*neni 364*) nga gjashtë (6) veprat penale të Armëve nga Kapitulli XXIX të Kodit Penal Nr.06/L-074 (*shih figurën c*).

Neni	Veprat penale të Narkotikëve - Kapitulli XXIII të Kodit Penal Nr.06/L-074
267	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge
268	Prodhimi dhe përpunimi i paaut. narkotikëve, subs. psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike
269	Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge
270	Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope
271	Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge
272	Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit
273	Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope
274	Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull
275	<i>Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull</i>
276	<i>Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit</i>

Figura a




Figura b

Neni	Veprat penale të Armëve- Kapitulli XXIX të Kodit Penal Nr.06/L-074
364	Importi, eksporti, furnizimi, trans., prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse.
365	<i>Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion</i>
366	<i>Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve</i>
367	<i>Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm</i>
368	<i>Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatare të rreme</i>
369	<i>Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale</i>

Figura c

Autor: Koordinatorin Nacional për Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional.